



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.1, datë 07.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “AB-01 ENERGJI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Ab-01 Energji”, sipas Miratimit Paraparak me Nr. 5932/3, datë 9.8.2018 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, për ndërtimin hidrocentralit “Gastra”, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Pashtreshit, degë e lumit Devoll, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan”, si dhe shtyrjes së afatit të miratimit paraparak për hidrocentral “Gastra” me anë të shkresës me Nr. 3962/1 Prot., datë 08.06.2022 “Për shtyrjen e afatit të Miratimit Paraparak për hidrocentral “Gastra”. për shoqërinë “AB-01 ENERGJI”.
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

HEC Gastra

Vendndodhja e veprës së marrjes/ burimi ujor Përroi i Pashtreshit

- X= 519917; Y= 4541115; Z=680 m.m.n.d. (KRGJSH)

- Prurja llogaritëse: 0.6 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.535 m³/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.097 m³/s
- Prurja ekologjike: 0.03 m³/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 517505; Y= 4538104; Z=425 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.6 m³/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 4.000.000 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 830 kwh
- Vlera totale e investimit: 116,749,203 lekë pa TVSH.

- Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
- Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

